



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec
RAHOVEC / ORAHOVAC



Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 238 Nr. i faq./Br.str./No.pg 67

Data/Date/Date 25.06.2024

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 19 paragrafi 3 pika 3.1 dhe 3.2 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 10/2019), konform nenit 22 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 25.06.2024, merr këtë:

V E N D I M

- Me këtë vendim, firmës **"Rahoveci Solar Energy Sh.P.K."**, me Nr. Biznesi: 811984500, me seli në Prishtinë, rr. Lord Bajron, të cilën e përfaqëson Ibrahim Kastrati, **I JEPET** në shfrytëzim afatgjatë deri **25 (njëzet e pesë) vjet** prona e paluajtshme e komunës, si në vijim:
 - Parcela, sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-02302-1, në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur *ravne shume*, me kulturë: Kullosë e klasës V, në sipërfaqe të përgjithshme prej 162513m² (njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind e trembëdhjetë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në emër të Komunës së Rahovecit; dhe
 - Parcela, sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-02299-0, në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur *grot*, me kulturë: arë e klasës VII, në sipërfaqe të përgjithshme prej 6806m² (gjashtë mijë e tetëqind e gjashtë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në emër të Komunës së Rahovecit.
- Pronat e paluajtshme, të cekura në pikën 1 të këtij vendimi, jepen për vendosjen e paneleve solare, sipas rekomandimit të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, me Nr. Prot. 1737, të datës 28.5.2024.
- Afati për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të komunës, fillon të rrjedhë nga data 1.8.2024 dhe përfundon më datën 1.8.2049, ndërsa, pas mbarimit të këtij afati, ose të ndërprerjes së parakohshme të kontratës, e drejta e shfrytëzimit i kthehet Komunës së Rahovecit si titullar faktik dhe juridik i pronës.
- Çmimi i dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të lartcekura do të jetë 2,539.78€ (dy mijë e pesëqind e tridhjetë e nëntë euro e shtatëdhjetë e tetë cent) në muaj. Realizimi i pagesës është cekur në nenin 3 të vendimit për dhënien e pëlqimit paraprak me Nr. Prot. 01, Nr. 198/24, i datës 29.2.2024.

5. Obligohet kryetari i Komunës që, me personin fizik dhe juridik përfitues të pronës së paluajtshme të komunës, të lidhë kontratë me të cilën i përcaktojnë të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.
6. Obligohet shfrytëzuesi i cekur në nenin 1 të këtij vendimi, që pronën e paluajtshme të cekur në nenin 1 të këtij vendimi, ta shfrytëzojë me mirëbesim si nikoqir i mirë, që mos t'ia humbë vlerën e saj.
7. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë prone.
8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.238/24
Me datë: 25.06.2024

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit

